



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura IV**

Kryesia e Kuvendit

P-072

Prishtinë, më 21 gusht 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 21 GUSHT 2012**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Bilall Sherifi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

**Nga OSBE-ja:** Lejla Selimi.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

### **R e n d i t e**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9 korrik 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

\* \* \*

#### **1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 9 korrik 2012**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 9 korrik 2012, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës**

Kryetari i njoftoi të pranishmit se seanca plenare e fundit, për mungesë të kuorumit, nuk arriti t'i shqyrtojë të gjitha pikat e rendit të ditës. Ai propozoi që seanca e parë të Sesionit vjeshtor të fillojë me pikat e mbetura të seancës së 12 korrikut 2012.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet më 30 gusht 2012, me këto pika të rendit të ditës:

1. *Votimi i tekstit të mocionit të Interpelancës së ministres Mimoza Kusari-Lila, sipas kërkesës së grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e MTI-së për vendosjen e tarifës prej 35% për importimin e çimentos,*
2. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi,*
3. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pasurimin e miellit,*
4. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftime,*
5. *Shqyrtimi i Raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian për vitin 2012,*
6. *Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011,*
7. *Shqyrtimi i Raportit vjetor dhe pasqyrave të audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011,*
8. *Debat parlamentar lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë, sipas kërkesës së deputetëve nënshkrues,*
9. *Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe*
10. *Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.*

### **3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave**

#### **3.1 Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Projektligjin e cekur më lart, nxori këtë:

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Kërkohe nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të japë mendim lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të hartuar nga grupi i deputetëve nënshkrues.
2. Kërkohe nga Ministria e Financave që ta bëjë verifikimin e ndikimit buxhetor të këtij projektligji.
3. Qeveria duhet ta paraqesë mendimin e vet me shkrim, në afatin prej një muaji nga dita e pranimit të Projektligjit, së bashku me Deklaratën për verifikimin e ndikimit buxhetor. Pas kalimit të këtij afati, Projektligji procedohet në Kuvend për shqyrtim.

#### **3.2 Procedimi i Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Projektligjin e cekur më lart, nxori këtë:

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Kërkohe nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të japë mendim lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, të hartuar nga grupi i deputetëve nënshkrues.
2. Kërkohe nga Ministria e Financave që ta bëjë verifikimin e ndikimit buxhetor të këtij projektligji.
3. Qeveria duhet ta paraqesë mendimin e vet me shkrim, në afatin kohor prej një muaji nga dita e pranimit të Projektligjit, së bashku me Deklaratën për verifikimin e ndikimit buxhetor. Pas kalimit të këtij afati, Projektligji procedohet në Kuvend për shqyrtim.

#### **3.3 Kërkesa e deputetes Alma Lama, mbështetur edhe nga shtatë deputetë të tjerë, për debat parlamentar lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës gjatë viteve 2010 dhe 2011**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

## **P Ë R F U N D I M**

1. Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta përgatisë një informatë lidhur me kërkesën e parashtruar nga deputetja Alma Lama për shpenzimin e fondeve publike në Kosovë gjatë viteve 2010 dhe 2011, mbi bazën e së cilës do të zhvillohet debati.
2. Informata e kërkuar sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi t'i paraqitet Kuvendit në afatin sa më të shkurtër të mundshëm.

### **3.4. Kërkesa e deputetit Visar Ymeri, mbështetur edhe nga gjashtë deputetë të tjerë, për debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë**

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

## **P Ë R F U N D I M**

1. Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta përgatisë një informatë lidhur me kërkesën e parashtruar nga deputeti Visar Ymeri, për procesin e privatizimit në Kosovë, mbi bazën e së cilës do të zhvillohet debati.
2. Informata e kërkuar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë t'i paraqitet Kuvendit në afatin sa më të shkurtër të mundshëm.

### **3.5 Miratimi i akteve për organizimin dhe klasifikimin e pozitave të Administratës së Kuvendit, sipas sistemit të ri të pagave**

Kryesia pikën e cekur më lart e shtyu për shqyrtim për mbledhjen e radhës së Kryesisë.

### **3.6 Njoftimi i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Maqedoni**

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të realizuar në Maqedoni.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën **11:55** minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

*Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*